



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:155024

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05499162

C.nr.660/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve N.N dhe S.D, që të dy nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, për shkak të kompensimit të shpërblimit jubilar, vlera e objektit të kontestit 689.81 euro, jashtë seancës, më datën 25.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve N.N dhe S.D.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses N.N, në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës t’ia paguajë 100% të pagës bazë (paga bazë 421*100% euro) në shumë prej 421.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 17.07.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit S.D, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës t’ia paguajë 75% të pagës bazë (paga bazë 252*75% euro) në shumë prej 189.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 17.07.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses N.N mbi shumën prej 421.00 euro e deri në shumën prej 484.40 euro dhe atë për shumën prej 63.40 euro.

V. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit S.D mbi shumën prej 189.00 euro e deri në shumën prej 205.00 euro dhe atë për shumën prej 16.00 euro.

VI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve N.N dhe S.D, t’i paguajë shumën prej 177.00 euro, në

afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit N.N dhe S.D, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 17.07.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për kompensimin e shpërblimit jubilar, vlera e kontestit në shumën prej 689.81 euro.

Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se ka qenë në marrëdhënie pune si mësimdhënës në SHFMU “Bajram Curri” në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, ku edhe vazhdojnë të punojnë në këtë institucion. Më tej kanë shtuar se e paditura në bazë të Kontratave Kolektive ka qenë e obliguar që paditëses N.N t’i paguajë shpërblimin jubilar për 100% të pagës bazë, ndërsa paditësit S.D t’i paguajë shpërblimin jubilar për 75% të pagës bazë duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi dhe ta detyrojë të paditurën në pagesën e kompensimit për shpërblimin jubilar.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 20.02.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi, e drejta e kompensimit mbi bazën në të cilën është thirrur pala paditëse, rezulton se është parashkruar në tërësi. Duke shtuar se paditësit nuk e plotëson kushtin për shpërblim jubilar, pasi që i njëjti vitet jubilarë nuk i ka arritur kur kjo kontratë ka qenë në fuqi. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në nenin 2 të dy kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë, këto detyrime nuk janë zbatuar nga niveli qendror i pushtetit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës pa nr. të protokollit, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses N.N; lista e pagës për muajin tetor 2022 të paditëses N.N; kontratën e punës për punëtor teknik pa nr. të protokollit, e datës 01.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit S.D dhe lista e pagës për muajin tetor 2022 të paditësit S.D.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kanë të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve pagesa e pagës jubilarë dhe a është kërkesa e parashkruar.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës pa nr. të protokollit, e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditëses N.N dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Bajram Curri” në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e listës së pagës për muajin tetor 2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësja N.N ka përvojë pune 30 vjeçare, si dhe e njëjta ka pagën bazë në lartësi prej 421.00 euro.

Me administrimin e kontratës së punës për punëtor teknik pa nr. të protokollit, e datës 01.09.2020, të lidhur ndërmjet paditësit S.D dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Bajram Curri” në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e listës së pagës për muajin tetor 2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësi S.D ka përvojë pune 22 vjeçare, si dhe i njëjti ka pagën bazë në lartësi prej 252.00 euro.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë të paditësve në lidhje me kompensimin e pagës jubilarë në shumën prej 421 euro për paditësen N.N dhe në shumën prej 189.00 euro për paditësin S.D. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit në lidhje me kompensimin e pagës jubilarë duke u bazuar në dispozitat e nenit 35 par.8.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 që parashihet se *“punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit”* nënpar. 8.2 *“për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë”* dhe nënpar. 8.3 *“për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë”*. Pra 100% e pagës bazë në shumën prej 421.00 euro, të paditëses N.N i bie që të jetë shuma e përgjithshme prej 421.00 euro, ndërsa 75% e pagës bazë në shumën prej 252.00 euro, e paditësit S.D i bie që të jetë shuma e përgjithshme prej 189.00 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e tyre e aprovoi pjesërisht pasi që është e bazuar në Kontratës Kolektive të Arsimit e Kosovës, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve në pjesën tjetër, dhe atë në shumën prej 63.40 euro, për paditësen N.N dhe në shumën prej 16.00 euro për paditësin S.D, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate paga bazë e paditëses N.N është në shumën prej 421 euro, dhe jo në shumën prej 484.40.20 euro, ndërsa paga bazë e paditësit S.D është në shumën prej 252.00 euro, dhe jo në shumën prej 273.88 euro, siç pretendojnë paditësit, i cili fakt është vërtetuar sipas listës së pagave. Gjykata vlerëson se në rastin konkret paditëses N.N i takon

kompensimi i shpërblimit jubilar në shumën prej 421.00 euro, ndërsa paditësit S.D i takon kompensimi i shpërblimit jubilar në shumën prej 189.00 euro, andaj ka vendosur si në diapozitivi të këtij aktgjykimi.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësit është dorëzuar më datën 17.07.2023, ndërsa paditësja N.N20 vitet jubilarë i ka arritur në vitin 2022, ndërsa paditësi S.D 20 vitet jubilarë i ka arritur në vitin 2020. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimin lidhur me kumatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.8.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.660/2023, më datën 25.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.